



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr.17, datë 16.03.2022

PËR

NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT KOMBËTAR TË TERRITORIT NR.14,  
DATË 28.07.2020 “PËR MIRATIMIN E LEJES SË ZHVILLIMIT PËR OBJEKTIN  
“KOMPLEKS ME FUNKSION BANIMI DHE SHËRBIMESH “TIRANA LAKE”,  
ME 17 KATE MBI TOKË DHE 2-4 KATE NËNTOKË,  
ME VENDNDODHJE NË BASHKINË TIRANË”

Në mbështetje të nenit 113, të Kodit të Procedurave Administrative; neneve 7, shkronja “ç”, 27 dhe 28, pika 1, të Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; neneve 9 dhe 10/1, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar; Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 519, datë 20.09.2017 “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të shoqërive “Building Construction Invest” sh.p.k dhe “Eldino” sh.p.k., Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Harta e Planvendosjes së Strukturave dhe Dokumenti i Rregullores së Veçantë që përmendet në pikën 2, të Vendimit të Këshillit Kombëtar të Territorit Nr. 14, datë 28.07.2020 “Për miratimin e lejes së zhvillimit për objektin “Kompleks me funksion banimi dhe shërbimesh “Tirana Lake”, me 17 kate mbi tokë dhe 2-4 kate nëntokë, me vendndodhje në Bashkinë Tiranë”, zëvendësohen me Hartën e Planvendosjes së Strukturave dhe Dokumentin e Rregullores së Veçantë, që i bashkëlidhen këtij vendimi.
2. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI


EDI RAMA



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

BELINDA BALLUKU

A large, stylized handwritten signature in blue ink, written over the text and partially overlapping the official seal.

ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

LEDIA TOTA

A large, stylized handwritten signature in blue ink, written over the text and partially overlapping the official seal.